



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES SË VEÇANTË TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 27 PRILL 2015**

**SA POSEBNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 27. APRILA 2015. GODINE**

**PRILL - APRIL  
2015**

## **Rendi i ditës**

1. Shënimi i 27 Prillit - Dita e Personave të Pagjetur

## **Dnevni red**

2. Obležavanje 27. Aprila - Dan Nestalih Lica

### **Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.**

KRYESUESI: Të nderuar pjesëtarë të familjeve të personave të pagjetur,  
Të nderuar deputetë,  
I nderuar kryeministër i Republikës së Kosovës, zoti Isa Mustafa,  
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,  
Të nderuar përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare,  
Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues të misionëve diplomatike në Kosovë,  
Të nderuar përfaqësues të bashkësive fetare,  
Të nderuara zonja,  
Të nderuar zotërinj të pranishëm,  
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Mirë se keni ardhur në seancën e veçantë me rastin e 27 Prillit - Ditës së Personave të Pagjetur!

Lidhur me seancën e sotme, e cila është një ngjarje e veçantë, një ditë e veçantë, e ftoj kryetaren e Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, deputeten Lirije Kajtazi, që ta marrë fjalën e rastit.

LIRIJE KAJTAZI: Të nderuar familje të personave të pagjetur nga periudha e luftës së fundit,  
Të nderuar nënkryetarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,  
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra, zëvendësministra,  
Të nderuar deputetë,  
Të nderuar ambasadorë dhe misionarë diplomatikë,  
Zbardhja e fatit dhe e vendndodhjes së personave që na mungojnë si pasojë e agresionit nga lufta e fundit në Kosovë vazhdon të jetë preokupim i përbashkët, si i familjarëve, ashtu edhe i institucioneve dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Edhe Java e Pagjeturve, nga 21 deri sot, më 27 prill, kur po mbahet kjo seancë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, është shprehje e respektit, e dhimbjes, e solidarizimit dhe e obligimeve që kanë institucionet e shtetit të Kosovës për këtë kategori të ndjeshme të familjarëve tanë, të cilët qe 16 vjet s'prajnë bashkë me ne duke i kërkuar më të dashurit që u mungojnë atyre dhe vetë Kosovës, qoftë si të gjallë, apo edhe martirizuar deri në hi për lirinë tonë.

Moszbardhja e fatit të të pagjeturve bën që Kosova të mbetet dosja e madhe e krimit të pandëshkuar, e fajtori dihet, ka adresë, dhe ky ishte shteti i Serbisë, i cili jo vetëm që nuk kërkoi falje, nuk shprehu as pas kaq vitesh pak humanitet, por sot e kësaj dite nuk e tregon së paku vendndodhjen e tyre.

Me konventa ndërkombëtare, krimet vazhdojnë deri në ditën e zbardhjes së tyre dhe jo vetëm të pagjeturit, por edhe familjarët e tyre vazhdojnë të viktimizohen edhe tutje nga ankthi i pritjes.

Qëndrimi i Serbisë nuk është i panjohur për ne dhe intervenimi humanitar ushtarak nga Aleanca Veriatlantike, për fat të keq, nuk e ka ndërruar mendësinë e qeverisjes së Serbisë.

Botës perëndimore, por edhe neve na mbetet punë për ta humanizuar atë. A s'është minimumi i humanes dhe seriozitetit të Qeverisë së tanishme serbe çështja e të pagjeturve? Kjo gjë nuk duhet t'i takojë politikës, ani se ka derivuar nga një politikë e keqe. Thjesht, është çështje humanitare.

Për t'u zgjidhur kjo çështje shumë e ndjeshme dhe për të ndodhur paqja në këto hapësira duhet sërish angazhim dhe presion ndërkombëtar, si garanci e zgjidhjes së fatit të të pagjeturve, aq më tepër kur dihet se agresioni ishte shtetëror dhe natyrisht se mund të dokumentohet më lehtë edhe nga arkivat serbe, por edhe nga dëshmitë e atyre që mbijetuan.

Në përvjetorët e dhimbjes kujtojmë më të dashurit që na mungojnë, të cilët u morën të gjallë nga vatrat e tyre stërgjyshore me qëllim të spastrimit etnik dhe për t'i zhdukur gjurmët u bartën dhe u fshehën nëpër vende të ndryshme në Serbi.

Ne, qytetarët dhe institucionet e Republikës së Kosovës obligohemi për t'u angazhuar edhe më tepër në zbardhjen e fatit të tyre dhe përfundimisht ta zgjidhim këtë çështje, e cila nuk po i mban pezull dhe me dhimbje të pashëruar vetëm familjarët, por edhe institucionet e shtetit, sepse jemi këtu falë flijimit të tyre.

Sot, Republika e Kosovës ecën sigurt në rrugën e saj të integritetit euroatlantik, me miqësi të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke lartësuar të drejtat e njeriut pa dallim etnie, gjinie e feje, duke vendosur drejtësi ligjore e sociale për secilin qytetar.

Pranimi dhe shpalosja e vuajtjeve dhe regjistrimi i përjetimit të viktimave që tregimi të jetë i njohur për të gjithë bëhet në funksion të drejtësisë, në gjetjen dhe ndjekjen ligjore të keqbërësve për t'u shkëputur nga mendësia e kaluar, duke ua dhënë rastin për të edukuar për hir të së ardhmes, rast që nuk po dëshirojmë ta shfrytëzojmë.

Sot kur Kosova vazhdon të ndërtojë dhe të promovojë paqe në rajon për hir të qytetarëve të saj dhe rajonit vazhdon përkushtimin e saj për një fqinjësi të mirë.

Në vazhden e saj kur Kuvendi i Republikës e nxori Marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, u pa si shpresë edhe për fatin e të pagjeturve. Për fat të keq, shteti serb prapë nuk udhëhiqet nga qasja humane, por nga politika luftënxitëse.

Shembulli apo kapitulli më i vrazhdë i kësaj politike është loja apo ploja me të pagjeturit, të cilët edhe kaq vite pas përfundimit të luftës i përdor për përfitime politike.

E vërteta për të pagjeturit është e vërteta për Serbinë, e cila flet për terror të organizuar shtetëror.

Dëshirojmë të besojmë, por një mendje që rrënon zor se ndërton. Kur gjërat kanë adresë është më lehtë të insistohet në zgjidhjen e tyre. Fryma humane e Bashkësisë Evropiane do të ngulfatet nëse Serbia ulet në tavolinën vendimmarrëse të BE-së duke e bartur dhe instaluar logjikën e kushtëzimit edhe atje.

Familjet tona, të cilat u goditën rëndë nga këto plagë të pashëruara të luftës, me të drejtë kërkojnë dhe presin përgjigje nga shteti i tyre se ku ndodhen më të dashurit e tyre.

Zbardhja e fatit të të pagjeturve, jo vetëm që ua lehtëson dhimbjet, por edhe i çliron nga ankthi shumëvjeçar i pritjes. Tek pas kësaj mund t'u themi se ka drejtësi, se ëndrrat e tyre për Kosovën shtet janë realitet, se Evropa që e aspirojmë nuk i duron krimet dhe kriminelët dhe se ajo është vendi ku qytetarët jetojnë në paqe, duke i gëzuar të drejtat njerëzore në plotëni, pa dallimi për secilin qytetar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në shenjë respekti për të gjithë ata që na mungojnë në Kosovë, e ftoj përfaqësuesin e familjarëve, zotin Bajram Qerkinaj, që është përfaqësues i familjeve të personave të pagjetur, për një fjalë rasti.

BAJRAM QERKINAJ: Faleminderit, kryesues i Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Përshëndes zotin Kadri Veseli, edhe pse nuk është këtu.

Të nderuar ndërkombëtarë në Kuvendin e Republikës së Kosovës,

I nderuar nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

I nderuar kryeministër Isa Mustafa,

Deputetë,

Ministra të nderuar,

I nderuar kryetar i Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq,

I nderuar kryetar i Komisionit Qeveritar për Personat e Pagjetur, Prenk Gjetaj,

Të nderuar ambasadorë, diplomatë, përfaqësues të Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Pagjetur, të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq të Kosovës,

Të dashur familjarë,

Kryetarë të shoqatave familjare,

Familjarë të nderuar,

Si familjar, por edhe si qytetar i Republikës së Kosovës, sigurisht se në raste të tilla kam emocione të përziera. Është e rëndë, shumë e rëndë të flas në raste të tilla të shënimit të përvjetorit, shënimit të datave tragjike të historisë tonë, data në të cilat përkujtojmë mijëra të vrarë, të masakruar, data në të cilat shtohet dhimbja e ankthi, por edhe rritet shpresa që më të dashurit tanë të na kthehen ashtu siç na i morën, na u kidnapuan të gjallë dhe u zhdukën dhunshëm, pa lënë gjurmë.

Mirëpo, sigurisht se është ngushëlluese për familjarët kur sot gjendemi në institucionet më të larta të vendit tonë - të Republikës së Kosovës. Në këto institucione dhe në këtë shtet për ndërtimin e të cilit u derdh shumë gjak, u desh të japim shumë, edhe më të dashurit tanë: fëmijët, prindërit, foshnjat dhe të gjithë ata që sot na mungojnë e nuk janë në mesin tonë. E dhanë më të shtrenjtën që Zoti mund t'ia japë një njeriu. Por, jemi të lirë dhe të gëzojmë këtë institucion, në të cilin sot një familjar u drejtohet juve këtu që jeni të pranishëm.

Prandaj, nuk do ta lë për fund siç është zakon. Qysh tani në fillim flas dhe kërkoj nga të gjithë ju që jeni këtu që ta doni më shumë njëri-tjetrin dhe të bashkëpunoni.

Ne kemi vuajtur shumë. Unë po flas në emër të familjarëve dhe të 1 650 vetave të pagjetur, në emër të familjarëve që vazhdojnë të vuajnë, në emër të familjarëve që vazhdojnë të presin lajme për fatin dhe vendndodhjen e më të dashurve të tyre, në emër të atyre familjarëve për të cilët lufta akoma nuk përfundoi dhe liria për ta nuk ka kuptim të plotë.

Pra, në emër të familjarëve që vazhdojnë të jetojnë dhe të vuajnë në pritje, me dhimbje e vuajtje. Vuajtja jonë, pritja jonë dhe dhimbja jonë duhet të jenë mësim dhe udhërrëfyes për ju.

Udhëheqës të nderuar që na e udhëhiqni këtë Republikë shumë të shtenjtë, Shteti ynë duhet të jetë mësim për gjeneratat e reja nga mbarë Ballkani, nga mbarë Evropa, them edhe nga mbarë bota, që të mos ketë luftë kurrë më, se askush nuk e dëshiron luftën. Dhe, përkundër dhimbjeve, ne familjarët gjejmë kurajë dhe lutemi që tragjeditë që na ndodhën dhe po na ndodhin të mos ndodhin për asnjë qenie njerëzore, te asnjë popull kudo që është duke jetuar.

Zhdukja masive e njerëzve fatkeqësisht ka përcjellë gjenerata të tëra, edhe më parë se sa tash ne në Kosovë. Babai im vdiq pa ditur për babanë e vet. Por edhe baba i tij vdiq pa ditur për babanë e vet, Zenelin. E ky Zeneli u shpall dëshmor i atdheut në 100-vjetorin e shpalljes së Republikës së Shqipërisë.

Nuk dua të flas vetëm për djalin tim. S'kam dalë këtu të flas vetëm për Reshatin, por sot dalë të flas më shumë për 100 fëmijë, të cilët i morën të gjallë. Asnjë nuk shkruan për ta se çfarë ndodhi. Ende s'dimë për fatin e tyre. Nën 18 vjeç! Është mëkat i madh që dikush të flasë për një shuplakë që ia ka dhënë një ushtar yni apo një komandant yni, e nuk flitet saktësisht për 101, që gjenden në duart e serbëve, apo nëpër varrezat e serbëve nëpër Serbi.

Vazhdon të jenë të pagjetur një numër shumë i madh, por besoj se me një angazhim tuajin më të madh, sepse ua kemi dhënë votat dhe e zbukuron këtë Kuvend - të gjakut, do të mund të bëjmë diçka më shumë.

E dimë mirë se fëmijët më së shumti i morën në Drenicë, sipas numrit, apo nënës, lokes 100-vjeçare, në Suharekë. Dhe, të gjithë personat e tjerë të pagjetur nga Meja, Krusha, Rezalla, Mitrovica, Gjakova, Kaçaniku, Podujeva dhe mbarë Kosova, nuk u kursye edhe 100-vjeçari, edhe 1-vjeçari, edhe foshnjat e porsalindura. Dhe, në këtë rast, zhdukja e dhunshme nga lufta e fundit, që ndodhi në fund të shekullit të kaluar, dhe vuajtjet tona edhe në këto dy dekada të fillimit të shekullit të ri, në mes të Evropës së civilizuar, në kohën kur ka avancuar demokracia, avancimi i zhvillimit në mbarë botën, ne i gjejmë fëmijët tanë të groposur me qëllim të fshehjes së gjurmëve të krimeve nëpërmjet gjenocidit, nëpër kazerna ushtarake, siç janë ato në Batajnicë, në Petrovo Sellë, apo në liqenet siç është Peruçaci, apo edhe në gropa të mbuluara me asfalt e me beton dhe në fund shtëpia të ndërtuara mbi to.

Kemi edhe shumë informata tjera, prandaj na duhet përkrahja e të gjithë juve, deputetë të gëzuar. Jo vetëm të flisni për politikë, por të flitni edhe për të pagjeturit. Me bashkësinë ndërkombëtare jo vetëm të kemi takime, por t'i bëjë edhe kushtëzim asaj Serbie, e cila vërtet e di ku i kemi më të dashurit tanë.

Që të punohet në lokacionet e reja dhe të kthehen sa më parë më të dashurit tanë, sepse fshehja e tyre dhe moskthimi në tokën amë, përveç se rrit dhimbjet tona, edhe ashtu të mëdha, shumëfishohet krimi i kryer nga kriminelët serbë. Prandaj, shteti serb duhet të heqë dorë njëherë e përgjithmonë nga e kaluara dhe koha e Milosheviqit dhe duhet të na japë përgjigje për fatin dhe vendndodhjen e familjarëve tanë.

Të nderuar të pranishëm,

Me këtë rast, me qëllim të përmbledhjes së fjalës time, do t'i paraqes gjashtë kërkesa për punën konkrete në emër të të gjithë familjarëve, që disa janë këtu e disa janë jashtë, disa edhe s'kanë pasur kushte për të ardhur.

Ne, familjarët e personave të pagjetur e kemi thënë gjithnjë - të pagjeturit e kanë vetëm një emër, ata janë të pagjetur. Kërkesat tona të përmbledhura në 6 pika janë:

1. Kërkojmë përshpejtimin e punës në gjetjen edhe të 1 650 njerëzve, të cilët tash e gjashtëmbëdhjetë vjet janë të pagjetur.

2. Kërkojmë që urgjentisht të fillojnë të veprojnë mekanizmat e drejtësisë, me qëllim që kryerësit serbë të krimeve të rënda të luftës dhe gjenocidit të nxirren para drejtësisë.

3. Kërkojmë që në dialogun e nivelit të Bashkimit Evropian ndërmjet dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë, të përfshihet edhe çështja e të pagjeturve. Këtë e kemi thënë shumë herë, po themi edhe sot pranë kësaj foltoreje të shenjtë.

4. Konsiderojmë se është i domosdoshëm përmirësimi i amendamenteve të Ligjit për personat e zhdukur të luftës në Kosovë, në të cilin kemi shumë vërejtje dhe i kemi dhënë edhe disa vërejtje me shkrim, se duhet të ndryshojë.

5. Kërkojmë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës ta përmbushë premtimin me shkrim nëpërmjet Rezolutës për ngritjen e Qendrës Memoriale në qendër të nivelit të vendit.

6. Mendojmë se ka ardhur koha që Komisioni Qeveritar i Republikës së Kosovës për Persona të Pagjetur të fuqizohet. Mendoj se ky komision punon, por s'ka fuqi. E keni për detyrë të uleni, të bisedoni dhe të na e forconi Komisionin Qeveritar, për shkak se nuk ka fuqi. Pra, të kemi mbështetjen nga të gjitha institucionet e pushtetit vendor, si dhe ato ndërkombëtare.

Megjithatë, do të isha jo i ndershëm, do të ishte jo e drejtë nga unë që ta përfundoj këtë fjalë pa e falënderuar për punën e deritashme. Ju e dini se e kemi pasur Javën e të Pagjeturve, që s'e kemi pasur deri më tash.

Të gjithë juve ju falënderoj, jo vetëm idenë e kryeparlamentarit, nën një, por edhe të gjithë juve që e keni përkrahur.

Deri më tash institucionet vendore dhe ndërkombëtare për ne familjarët s'kanë bërë aq sa duhet, por atë që e kanë bërë, në fjalën time i falënderoj: Komisionin Qeveritar për Persona të Zhdukur, Komisionin Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur, Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, Kryqin e Kuq të Kosovës, ekspertët tanë dhe ekspertët e EULEX-it në kuadër të mjekësisë ligjore, për aq sa kanë mundur të bëjnë dhe të gjithë ata të tjerët që në një formë apo tjetër e kanë ndjerë dhembjen me ne dhe ishin e janë me ne në këto ditë shumë të përgjakshme, në këto ditë shumë të përkujtueshme, në këto ditë që familjet s'kanë mundur të flenë.

I nderuar kryesues,  
I nderuar kryetar i Kuvendit,  
Kemi respekt, kur Presidentja ka dashur të udhëtojë, ka pasur dëshirë ta caktojë dhe e ka thirrur dhe një grup dhe është arsyetuar përse sot nuk është në mesin tonë. Ia dimë shumë për nder!

Deputetëve të cilët sot s'janë këtu, edhe atyre ua dimë për nder, se me siguri kanë ndonjë arsye. Na keni nderuar, po na nderoni, me mundësitë që na i keni dhënë dhe ua dimë për nder dhe jemi mirënjohës si familjarë. Faleminderit, të nderuar!

Kanë thënë të parët tanë: "I nderuari të nderon!". Ju jeni ata që e keni nderuar popullin, i keni marrë votat e popullit - jeni të nderuar dhe na keni nderuar.

Por, ne jemi një popull fisnik, dhe të mirën e të keqen i ndajmë së bashku dhe së bashku kërkojmë të jemi prapë dhe të vazhdojmë së bashku deri në ndriçimin e fatit të personit të fundit të pagjetur, derisa edhe ai të gjendet. Është mirë që sot ngrihet një përmendore dhe duhet të falënderohemi për këtë, që derisa të zbardhet fati i atij të fundit ajo të jetë në atë vend.

Në fund, e përshëndes kryetarin e Komisionit Qeveritar, që ka më së shumti punë me ne familjarët dhe të gjithë ata që patën durim të më dëgjojnë mua si një familjar, ndoshta me shumë gabime, por edhe me porosi të veçanta, në emër të familjarëve, që disa janë e disa nuk janë këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Qerkinaj!

Të nderuar të pranishëm,

Ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe me këtë përmbysim punimet e kësaj seance të veçantë me rastin e 27 Prillit - Ditës së Personave të Pagjetur. Andaj ju ftoj që bashkërisht të marrim pjesë në zbulimin e përmendores.

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*